



UNMIK

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

Në përputhje me nenin 2 dhe 3 të Ligjit nr.2002/1 mbi Metodologjinë e caktimit të lartësisë së Pensionit bazë në Kosovë dhe caktimin e datës për sigurimin e pensioneve bazë, pastaj në marrveshje dhe konsultim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 7/2004
PËR PËRCAKTIMIN E LARTËSISË SË PENSIONIT BAZË
NË KOSOVË PËR VITIN 2004**

Neni 1

1.1 Shuma e pensionit bazë për personat që e gëzojnë këtë të drejtë në Kosovë për vitin 2004, përcaktohet në lartësi prej **40.00 €(euro) në muaj.**

Neni 2

2.1 Në pajtim më lehtësuesin e aplikueshm në Kosovë, edhe shuma e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara dhe për pensionet e parakohshme të punëtorëve të Kompleksit “**TREPÇA**” për vitin 2004 do të jetë **40.00 €(euro) në muaj.**

Neni 3

3.1 Shuma e përcaktuar e pensionit bazë, dhe pensioneve të potencuara në nenin 2 të këtij Udhëzimi, mbështetet në vlerën minimale të shportës ushqimore siç është definuar në nenin 2 të Ligjit mbi metodologjinë e caktimit të lartësisë së pensionit bazë në Kosovë dhe ligjeve të tjera të aplikueshme në vendin tonë.

Neni 4

- 4.1** Mjetet buxhetore për pensionet bazë dhe ndihmat e tjera pensionale sigurohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, me ç'rast Autoriteti Qendror Fiskal, në Administratën Pensionale të Kosovës, bën transferimet e mjeteve në baza mujore, në përputhje më planin vjetor të miratuar nga Kuvendi i Kosovës apo PSSP-ja (Përfaqësusi Special i Kombeve të Bashkuara)

Neni 5

- 5.1.** Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi menjëherë, ndërsa do të aplikohet në mënyrë retroaktive nga **01.01.2004**

Prishtinë, Shkurt 2004

**Mistri i MPMS-së
Ahmet Isufi**
